



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. _____ Prot

Tirane, ____/____2018

**SHPLLJE VETËM PËR NËNPUNËS CIVILË
PËR PRANIM NË POZICION TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES**

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr.152/2013, "Për nënpunësin civil", i ndryshuar si dhe të Kreut VIII dhe IX të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.118, datë 5.03.2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall procedurat e konkurimit për pozicionin:

Nd/Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Pozicioni i mësipërm është i hapur vetëm për nënpunësit civil të kategorisë së mesme drejtuese (kategoria II-b)

Data e fundit e dorëzimit të dokumentave për aplikim është dt.17 Janar 2019.

1. Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Nd/Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve :

-Të trajtojë, shqyrtojë, verifikojë rastet që përcillen nga Komisioneri i Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, Sekretari i Përgjithshëm ose në

mënyrë direkte nga Avokati i Popullit, çështje që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

1- Të monitorojë zbatimin e respektimin e të drejtave të fëmijëve në institucionet shtetërore (qendrat rezidenciale të përkujdesit shoqëror, qendrat e zhvillimit, shkollat, kopshtet, çerdhet, spitalet, burgjet, komisariatet e policisë, etj).

2- Të vendosë dhe të forcojë bashkëpunimin me aktorët kryesorë rajonalë për të drejtat e fëmijëve.

3- Të marrë pjesë në fushata ndërgjegjësuese për të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, institucionet e pavarura e organizatat jofitimprurëse

4- Të monitorojë zbatimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijës”, si dhe të gjitha dokumentave të tjera ndërkombëtare e evropiane që kanë lidhje me mbrojtjen e respektimin e të drejtave të fëmijëve të ratifikuara nga Shteti Shqiptar.

5- Të propozojë rastet që mund të ndiqen me inisiativë, të bëra publike ne median e shkruar apo atë vizive.

6- Të kryejë inspektime pranë organeve të Administratës Publike qendrore apo vendore, si dhe në terren, dhe vendet ku ka sinjalizime/njoftime për shkelje të të drejtave të fëmijëve.

7- Të monitorojë zbatimin e Konventave të Ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, dhe të përgatisë informacione apo rekomandime për raportet periodike të monitorimit të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

8- Të hartojë rekomandime për çështje të veçanta apo edhe rekomandime legjislative në rastet kur vetë ligji apo akti nënligjor përbën premisë për shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

9- Të marrë pjesë në grupet e hartimit të raporteve të veçanta dhe ndjekjen në vijim të rekomandimeve të dala gjatë hartimit të tyre.

10- Të jetë aktiv në mediat vizive dhe të shkruara me intervista apo edhe emisione të drejtpërdrejta mbi problematikat që lidhen me të drejtat e fëmijëve.

11- Të zbatojë me përpikmëri urdhërat, udhëzimet dhe porositë që i jepen në vijë vertikale, sipas shkallës hierarkike nga varet.

12- Të ushtrojë çdo kompetencë tjetër që i jepet nga eprori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion janë si më poshtë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë e mesme drejtuese (kategoria II-b)
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë vlerësimin e fundit shumë mirë ose mirë.

3. Kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion janë si më poshtë:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në Shkencat Juridike/Psikologji/Punë Sociale. Edhe Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- Të zotërojë gjuhën angleze ose një gjuhë të BE-së (të vërtetuar me certifikatë)
- Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në Administratën Publike nga të cilat të paktën 2 vite në nivel të mesëm drejtues (kategoria II-b)
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

4. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit dokumentat si më poshtë vijon:

- a.** Letër motivimi për aplikim për vendin vakant, një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive për komunikim
- b.** Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- c.** Fotokopje e Diplomës
- ç.** Fotokopje e Librezës së Punës
- d.** Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit, brenda datës 17 Janar 2019 .

5. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara

në shpalljen për konkurim dhe në datën **28 Janar 2019** do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institutit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar do të njoftohen me e-mail nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Institutit të Avokatit të Popullit, dhe kanë të drejtë të paraqiten prane saj për t’u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

6. Fusha e njohurive dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët:

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin Nd/Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin për të Drejtat e Fëmijëve do të vlerësohen në lidhje me:

A. Njohuri për:

1. Ligji nr.76/2016 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Ligji nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
3. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në datën 20 Nentor 1989 Lanzarote.
4. Ligji nr.86.2013 Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve “Për Procedurën e Komunikimit”
5. Protokollin Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijët.
Ratifikuar me Ligjin nr.9834, datë 22.11.2007 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së”.
6. Ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Miturit”
7. Ligji nr.152/2013, “Për Nënpunësin Civil”, i ndryshuar

B.Aftësitë për të:

- Menaxhuar situata emergjente
- Menaxhuar situata të cilat nuk kanë qënë të parashikuara
- Marrë vendime mbi bazën e argumentave
- Shprehur opinion dhe argumenta në mënyrë të rrjedhshme dhe të sjellshme
- Respektuar të tjerët (kolegët, vartësit, qytetarët) dhe dëgjuar opinionet e tyre.
- Bashkëpunuar me kolegët, duke ndarë me ta informacionin dhe njohuritë e nevojshme
- Kominikuar procesin e vendimmarrjes bazuar në argumenta dhe analizë të pasojave
- Ndërmarrë nisma të ndryshme strategjike dhe afatgjata brenda kompetencave të funksionit me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale, përmbushjen e objektivave dhe përcaktimin e rrugëve dhe hartimin e planeve për mënjanimin e risqeve në realizimin e tyre, duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore dhe material me kosto sa më të ulët dhe me rendiment maksimal.

7. Mënyra e vlerësimit të kamdidatëve

Faza e konkurimit konsiston në:

- a) Vlerësimin e Jetëshkrimit (CV) të kandidatëve që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore 10 pikë
- b) Testimi me shkrim, 40 pikë
- c) Intervista e striktuar me gojë, 50 pikë

Testimi me shkrim dhe intervista me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, të aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën e kompetencës si më lart.

8. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kamdidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në datën **22 Shkurt 2019** do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë Institucionit.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334, ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi: “Zhan’ Dark” nr.2 - Tiranë